



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR LINJAT E TRANSMETIMIT TË TENSIONIT TË LARTË TË KASKADËS SË HEC-VE TË FANIT, "LINJA E HEC-IT PESHQESH" DHE "LINJA E HEC-IT FANG", ME VENDNDODHJE PËRKATËSISHT NË FSHATIN PESHQESH, KOMUNA OROSH DHE FSHATIN FANG, BASHKIA RUBIK

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit.

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për linjat e transmetimit të tensionit të lartë të Kaskadës së Hec-ve të Fanit, "Linja e Hec-it Peshqesh" dhe "Linja e Hec-it Fang" me vendndodhje përkatësisht në fshatin Peshqesh, komuna Orosh dhe fshatin Fang, bashkia Rubik dhe subjekt kërkues shoqërinë konçensionare "Ayen As Energji" sh.a.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësive të Qeverisjes Vendore ku shtrihet Linja e Transmetimit.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA ÇIERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**Z. DAMIAN GJIKNERI**

**MINISTËR I ENERGIJË DHE INDUSTRIJË**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Handwritten signature of Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**